

VENDIM
Nr.57, datë 5.12.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar i““““
Manol Konomi,	Anëtar i““““
Veli Budo,	Anëtar i““““
Zija Vuci,	Anëtar i““““
Franc Jakova,	Anëtar i““““
Alfred Karamuço,	Anëtar i““““
Halil Kopani,	Anëtar i““““
Kristofor Peçi,	Anëtar i““““

më datat 25. 11.1997 dhe 5.12.1997 mori në shqyrtim me nismën e saj në këshill çështjen nr.61 Akti,

O B J E K T I:

Kushtetutshmeria e nenit 2 të ligjit nr.8257, datë 19.11.1997 "Për një plotësim në ligjin nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491 datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi shqyrtoi dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata Kushtetuese në këshill dhe me përbërje të plotë mori në shqyrtim ligjin nr.8257, datë 19.11.1997 dhe sidomos përmbajtjen e nenit 2 të këtij ligji: "Gjykata Kushtetuese të zhvillojë rotacionin e parë brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji".

Sipas nenit 18 paragrafi i tretë i ligjit nr.7561, datë 29.4.1992, Gjykata Kushtetuese duhet të përtëritet në krye të tre vjetëve.

Gjykata Kushtetuese e ndodhur përpara faktit se në pragun e mbarimit të trevjetorit të parë tre anëtarë të saj u larguan nga kjo Gjykatë dhe pothuaj njëkohësisht u emëruan tre anëtarë të rinj, shtrohej problemi nëse në këtë rast u plotësua kërkesa e nenit 18 të ligjit të lartpërmendur për përtëritjen e saj në krye të tre vjetëve.

Gjykata me vendimin e saj nr.4, datë 2.6.1995 me shumicë votash e konsideroi të kryer ripërtëritjen e saj dhe rrjedhimisht nuk ishte e nevojshme hedhja e shortit.

Me ligjin nr.8257, datë 19.11.1997 (neni1) bëhen disa ndryshime e plotësime në nenin 18 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 dhe shtohet një nen i ri, neni 2 me përmbajtjen e përmendur në krye të këtij vendimi të Gjykatës.

Në raportin justifikues që shoqëron ligjin e paraqitur nga një grup deputetësh, të kthyer në ligj me miratimin e tij nga Kuvendi Popullor, tregohen me hollësi shkaqet që kanë diktuar nevojën e paraqitjes të projektligjit në fjalë. Këto shkaqe, në mënyrë të përmbledhur janë :

a) Gjykata Kushtetuese nuk e ka kryer detyrën e saj, por ka vepruar në kundërshtim me normat që përcaktojnë përtëritjen e saj në mbarimin e afatit të parë trevjeçar të zgjedhjes së saj;

b) Gjykata Kushtetuese vazhdimisht dhe sidomos me vendimin e saj të fundit (shpallja antikushtetues të nenit 7 të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997"Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë") ka shkelur haptazi dispozitat dhe frymën e dispozitave kryesore kushtetuese;

c) Duke mos kryer ripërtëritjen që urdhërohet nga ligji, "Gjykatës Kushtetuese është e nevojshme t'i ndalohet kryerja e mëtejshme e funksioneve të saj si konstitucionalisht e

delegitimuar";

d) Interpretimi i gabuar i bërë nga Gjykata Kushtetuese i nenit 18 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 dhe moskryerja e përtëritjes tregon se ajo ka karakter politik, gjë të cilën e tregon edhe me qëndrimin që ajo mbajti ndaj masave me karakter social të Qeverisë.

Gjykata Kushtetuese, duke marrë parasysh se:

Në bazë të nenit 17 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Gjykata Kushtetuese është autoriteti më i lartë që mbron dhe garanton respektimin e kushtetutës dhe të legjislacionit si dhe bën interpretimin përfundimtar të kushtetutës", ky nen shton se: "në ushtrimin e funksioneve të saj, ajo është e pavarur dhe i nënshtrohet vetëm kushtetutës".

Parimi i shprehur në normën e sipërme kushtetuese përforcohet me përmbajtjen e nenit 26 paragrafi i dytë, të të njëjtit ligj kushtetues, i cili disponon se: "Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të formës së prerë".

Siç thuhet në nenin 24 pika 1 i po këtij ligji, "interpretimi i kushtetutës dhe i ligjeve kushtetuese është në kompetencën ekskluzive të Gjykatës Kushtetuese".

Del e qartë nga përmbajtja e dispozitave të sipërme se vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk i nënshtrohen asnjë kontrolli dhe se ato janë të detyrueshme për të gjitha organet shtetërore, duke mos përjashtuar as organin ligjvënës.

Ligjvënësi edhe kur vepron me cilësinë e organit konstituent nuk ka të drejtë, duke revizionuar një dispozitë konstitucionale (në formë përmirësimi ose plotësim të kësaj dispozite) të shfuqizojë vendimet interpretative të Gjykatës Kushtetuese të marrë në mbështetje (në interpretimin e tyre) të normave të mëparshme në fuqi. Kjo do të vinte ndesh me vetë ligjin tonë kushtetues.

Shfuqizimi nga Kuvendi Popullor i vendimeve të gjykatës në përgjithësi dhe të vendimeve të saj interpretative, kur gjykohen se janë marrë në kundërshtim me normat konstitucionale ose me ligjin do të dobësonin së tepërmi rolin e saj si garante e kushtetutës dhe e legjislacionit, vendimet e saj do të ishin vulnerable.

Në përmbajtjen e nenit 2 të ligjit nr.8257, datë 19.11.1997, nuk flitet për shfuqizimin e vendimit nr.4, datë 2.6.1995 të Gjykatës Kushtetuese mbi interpretimin e nenit 18 paragrafi i tretë i ligjit nr.7561, datë 29.4.1992, por duke patur parasysh shkaqet e parashtruara në relacionin e projektit dhe duke bërë një analizë logjike dhe ligjore të përmbajtjes së këtij neni, arrihet në konkluzion se Vendimi nr.4, datë 2.6.1995 shfuqizohet dhe si rrjedhojë veprimtaria e saj, pas marrjes së këtij vendimi quhet e delegitimuar. Duke vepruar në këtë mënyrë Kuvendi Popullor i ka kapërcyer kompetencat e tij kushtetuese.

Siç u përmend në krye të këtij vendimi, në dy paragrafe të veçanta të raportit justifikues, ndër të tjera, theksohet se kjo Gjykatë duke interpretuar në mënyrë të qëllimshme nenin 23 si "rotacion", ka vepruar në kundërshtim me normat kushtetuese përkatëse dhe, me paraqitjen e projektligjit dhe miratimit të saj, t'i ndalohet kryerja e mëtejshme e funksioneve të saj si konstitucionalisht e delegitimuar në realizimin e përbërjes së saj.

Raportet justifikuese që shoqërojnë një projektligj ose një propozim për ligj, që i paraqiten ligjvënësit për miratim, nga organet që kanë të drejtën e iniciativës legjislative ose nga një e katërta e deputetëve, kanë një rëndësi të madhe, sepse shërbejnë si bazë dhe janë një ndihmë për gjyqtarin dhe studiuesit, për kuptimin e frymës dhe të përmbajtjes të një ligji ose të një dispozite të veçantë të tij, kur ajo është e paqartë, ekuivoke ose kontradiktore. Në këto raporte pasqyrohen: shkaku, objekti dhe qëllimi i ligji, përmbledhur në një term të vetëm "ratio legis".

Arsyet e parashtruara në raport për projektligjin nuk pajtohen me qëllimin e përbashkët e tërësor kushtetues që synohet të arrihet me një ligj. Vlerësimet negative e denigruese me karakter thellësisht politik për veprimtarinë e Gjykatës Kushtetuese në tërësi e deri edhe për vendime konkrete të saj, nuk mund të shërbejnë aspak si argumente për nevojën e miratimit të një ligji kushtetues.

Parashtrimi në raport se Gjykata me vendimin e saj të fundit i është kundërvënë masave sociale të Qeverisë, është argumenti më i plotë dhe treguesi më i qartë i ndërhyrjes në

veprimtarinë e Gjykatës dhe i kundërvënies ndaj pavarësisë së saj.

Neni 2 i ligjit nr.8257, datë 19.11.1997 shton një nen të ri me përmbajtje: "Gjykata Kushtetuese të zhvillojë "rotacionin" (lexo përtëritjen) e parë brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji".

Norma juridike e këtij neni ka një kuptim të caktuar. Me anën e saj - kur nuk mbeten veçse pak muaj për të bërë ripërtëritjen e dytë - urdhërohet Gjykata të bëjë përtëritjen brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit, gjë që vjen në kundërshtim të hapur me Vendimin nr.4, datë 2.6.1995 të Gjykatës, e cila me këtë vendim të saj përtëritjen e ka quajtur të kryer gjer në përtëritjen e dytë. Dhe nuk është e rastit që në këtë nen (neni 2) përdoret termi "rotacion i parë". Kjo presupozon se përtëritja e parë - pavarësisht se vendimi është ose jo i ligjshëm dhe pavarësisht se është marrë me unanimitet ose me shumicë votash - konsiderohet e pavlefshme.

Shfuqizimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese ose të quajturit të tij si të pavlefshëm, passjell detyrimisht delegitimitetin e saj. Ajo për një kohë të gjatë ka kryer funksionet e saj në virtut të një vendimi të "kundërligjshëm" dhe ka marrë vendime me përbërje jo të "rregullt", e metë kjo esenciale për një proces equitabel, gjë që vjen në kundërshtim me ligjin tonë kushtetues dhe me parimet që përmban korpusi i ri europian (neni 8 i ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese").

Kushtetutat, në kushtet e sotme të zhvillimit të shoqërisë, nuk kanë më karakterin e ngurtë të dikurshëm. Ato, nën ndikimin e kushteve të reja, janë elastike, por kjo nuk do të thotë kurrësesi se ato ose dispozita të tyre të veçanta, mund t'i nënshtrohen procesit të revizionimit të shpeshtë të diktuar nga çështje të rastit, sepse do të humbisnin kështu karakterin e ligjit themelor, bazë dhe burim i së drejtës pozitive dhe do të mirrnin trajtat e një ligji të zakonshëm.

PËR KËTO ARSYE, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 25 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me shumicë votash,

VENDOSI

1. Rikonfirmohet se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për të gjitha organet shtetërore, duke përfshirë dhe organin ligjvënës dhe të quaj vendimin e saj nr.4, datë 2.6.1995 të vlefshëm gjer në kryerjen e përtëritjes së dytë, në muajin maj 1998.

2. Konstatohet pavlefshmëria konstitucionale e nenit 2 të ligjit nr.8257, datë 19.11.1997 "Për një plotësim në ligjin nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.
Votuan kundër zotërinjtë Veli Budo e Zija Vuci.

MENDIMI I PAKICËS

Në mënyrë kategorike jam kundër, qëndrimin që mbajti shumica e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, e cila me nismën e vet vuri, në diskutim dhe ia nënshtroi kontrollit të saj konstitucional nenin 2 të ligjit nr.8257, datë 19.11.1997 "Për një plotësim në ligjin nr. 7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

Për më tepër, nuk pajtohem me zgjidhjen që i dha ajo, çështjes dhe që doli me një vendim, i cili vjen në kundërshtim me rolin dhe detyrat e saj, si autoriteti më i lartë që mbron dhe garanton respektimin e kushtetutës.

Duke iu referuar vetëm dispozitivit të këtij vendimi, jam i mendimit se në këtë rast Gjykata Kushtetuese i ka kaluar caqet e kompetencave të saj .

Ajo është shprehur për pavlefshmërinë konstitucionale të nenit 2 të ligjit të sipërpërmendur, pa përfillur faktin se kjo është një normë e një ligji kushtetues, i cili është miratuar nga parlamenti, duke u respektuar të gjitha rregullat e procedurës të kërkuara nga kushtetuta për formimin dhe nxjerrjen e ligjeve me karakter kushtetues.

Pra, në aspektin e saj forma1 kjo dispozite e ligjit nuk ka asnjë lloj vesi apo mangësie, shkak ky i vetëm që do ta lejonte Gjykatën për ta shpallur atë të pavlefshme ose inekzistente, pavarësisht nga emërtimi i saj si normë kushtetuese.

Por, përsa i përket vlerësimit në meritë të kësaj dispozite, dmth., nëse ajo ka ose jo të meta substanciale, nëse është e drejtë ose e padrejtë, pajtohet apo nuk pajtohet me normat e tjera kushtetuese, duhet të shfuqizohet apo të shpallët e pavlefshme, kjo është një çështje që nuk i takon Gjykatës Kushtetuese.

Në bazë të nenit 24 pika 1 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", kompetencat e kësaj Gjykate në lidhje me këtë kategori normash juridike shtrihen deri tek interpretimi i tyre dhe kurdoherë ky interpretim duhet të jetë në përputhje të plotë me vullnetin dhe qëllimet që ndjek ligjvënësi konstituent. Çdo operacion tjetër i saj, që del jashtë këtyre caqeve dhe që nuk mbron, por përkundrazi prek përmbajtjen e këtyre normave, pavarësisht nga ndonjë e metë e tyre me karakter substanciale, cenon parimin e pavarësisë së pushtetit legjislativ .

Shfuqizimi apo ndryshimi i këtyre normave në qoftë se këto kanë të meta të kësaj natyre, është atribut vetëm i këtij pushteti dhe i asnjë organi tjetër .

Fakti se ekziston një vendim i Gjykatës Kushtetuese, e cila në muajin maj të vitit 1995, ka interpretuar nenin 18 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për Organizimin e Drejtësisë dhe Gjykatën Kushtetuese", nuk do të thotë se ky vendim i vazhdon efektet e tij edhe pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri nr.8257, datë 19.11.1997.

Me këtë ligj dhe konkretisht me nenin 1 të tij, i është bërë një shtesë nenit 18 të ligjit nr.7561, datë 29. 4.1992 "Për Organizimin e Drejtësisë dhe Gjykatën Kushtetuese". përmbajtja e kësaj shtese është e prerë dhe pa ekuivoke, krejt e kundërt me qëndrimin që ka mbajtur Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr.4, datë 2. 6.1995.

Kështu, ndryshe nga sa pranohet në këtë vendim, në paragrafin e parë të nenit 1 të ligjit të sipërpërmendur është parashikuar në mënyrë të shprehur se : "Zëvendësimi i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese për shkaqet e treguara në nenin 23 nuk konsiderohet rotacion " .

Në këtë mënyrë kjo dispozitë e ligjit, duke bërë këto shtesa në nenin 18 të ligjit nr.7561, datë 29. 4.1992 e ka qartësuar përmbajtjen e tij të mëparshme evazive. Është pikërisht ky lloj formulimi i atëhershëm i këtij neni që e detyroi në atë kohë Gjykatën Kushtetuese, për shkak të qendrimeve të ndryshme në gjirin e saj , të merrej me interpretimin e kësaj dispozite dhe me shumicë votash t'i jeptë asaj një kuptim krejt tjetër nga ai që i jep ligji shtesë.

Mirëpo, është parim i njohur se kur një ligj i ri ndryshon njëligj të mëparshëm, të njëjtin fat ndjekin edhe interpretimet që i janë bërë këtij: për pasojë, me hyrjen në fuqi të ligjit të ri nr.8257, datë 19.11.1997, ka rënë nga fuqia interpretimi i bërë me vendimin nr.4, datë 2. 6.1995 të Gjykatës Kushtetuese.

Ky konkluzion përforcohet edhe me faktin se vetë shumica e Gjykatës Kushtetuese në vendimin e saj datë 5.12.1997, nuk e ka prekur farë nenin 1, ashtu siç ka vepruar me nenin 2 të këtij ligji, që për këtë dispozitë ajo bën konstatimin e pavlefshmërisë konstitucionale të saj .

Kështu, aktualisht kanë mbetur përballë njëri-tjetrit vendimin nr.4, datë 2. 6.1995 i Gjykatës Kushtetuese i rikonfirmuar me vendimin e saj të fundit dhe neni 1 i ligjit të ri nr.8257, datë 19.11.1997, që nuk është shfuqizuar as nga parlamenti as është shpallur në mënyrë të shprehur i pavlefshëm nga Gjykata Kushtetuese.

I pari, urdhëron që ripërtëritja e kësaj Gjykate të bëhet në muajin maj të vitit 1998 dhe kriteret e caktuara për realizimin e saj të zbatohen për gjithë periudhën e ekzistencës së Gjykatës Kushtetuese, kurse i dyti, dmth. , nenin 1 i ligjit në fjalë, urdhëron qëkjo ripërtëritje të bëhet 30 ditë pas hyrjes së tij në fuqi, duke caktuar kriteret e tjera për pjesëmarrjen në short të anëtarëve të

kësaj Gjykate.

Në këto rrethana, mendoj se duhet të prevalojë ligji, përderisa ky si ligj kushtetues nuk është shfuqizuar nga Parlamenti dhe jo vendimi nr.4, datë 2. 6.1995 i Gjykatës Kushtetuese, siç vendosi shumica e anëtarëve të saj .

Tiranë, më 5.12.1997

Anëtari
Zija Vuci